



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA LIGJORE  
SEKTORI PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Durrës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2020

Lënda : Formulari i Njoftimit të Fituesit

Për: ZEQIRI shpk, Adresa: Fier, Lagja Bishanak, rruga Skenderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banesë private, Pasuria nr.1/1088, Kati I-rë.

Procedura e prokurimit: “ E hapur ”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-72957-09-24-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës : “Blerje kazana per mbetje urbane”, me fond limit 12’474’000 lekë, sasia sipas preventivit, afati 40 ditë.

Publikime të mëparshme(*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Nr.77 datë 28 Shtator 2020]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  X, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- |  |            |
|--|------------|
| 1. ZEQIRI  | J67902827A |
| Vlera 10’684’800 (dhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë.          |            |
| 2. R & R GROUP   | K81415001A |
| Vlera 10’852’128 (dhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e njezet e tetë) lekë. |            |
| 3. LUAR Bros   | L72322004M |
| Vlera 11’471’040 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyzetë) lekë.        |            |
| 4. EGLAND  | J96829419D |
| Vlera 11’760’000 (njëmbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.                     |            |
| 5. KLOSI-R COMPANY   | L72120030I |
| Vlera 11’827’200 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e dyqind) lekë.            |            |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. R & R GROUP	K81415001A
2. EGLAND	J96829419D
3. KLOSI-R COMPANY	L72120030I

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Per ofertuesin R&R GROUP me vlerë të ofertës 10.852.128 lekë, KVO konstaton keto probleme:

1- Në DST, Shtojca 9, pika 1. “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” pika a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

- Ofertuesi R&R GROUP ne fushen e veprimtarise te QKR-se, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

2- Në DST, Shtojca 9, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, germa “f”,  
*Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 4’900’000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) vitevetë fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme.....*

Ofertuesi R&R GROUP, ka paraqitur faturë tatimore me Nderrmarjen e Sherbimit Publik Korce, dhe jo kontratë. Pershkrimi i mallit nuk ka lidhje me furnizim te ngjashëm qe kerkohet në tender.

Ka paraqitur disa fatura tatimore me subjekte private por pershkrimi i mallit nuk ka lidhje me kazanë por me mjete, kamion, eskavator etj.

3- Në DST, Shtojca10, “Specifikimet teknike”,  
Referuar specifikimeve teknike, ofertuesi duhet të disponojë certifikatat: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, në të cilat duhet te jete i perfshire objekti i prokurimit.

- Në certifikatat e paraqituara nga ofertuesi përkatësisht: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 tek fusha e certifikimit nuk është përfshire objekti i prokurimit.

4 - Në DST, Shtojca 9, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, germa “j”,  
*Çertifikat: Sistemi manaxhimit te Operacionit te saldimit EN (ISO 3834-4) : 2005....*

- Ofertuesi R&R GROUP ka paraqitur certifikatën: EN (ISO 3834-2) dhe jo EN (ISO 3834-4)

KVO vendos qe ofertuesi R&R GROUP të mos kualifikohet.

- Për ofertuesin EGLAND me vlerë të ofertës 11’760’000 lekë, KVO konstaton këto probleme:

1- Në DST, Shtojca 9, pika 1. “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” pika a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

- Ofertuesi EGLAND në fushën e veprimtarise te QKR-se, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

2- Në DST, Shtojca 9, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, germa “f”,

*Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 4'900'000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) vitevetë fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme.....*

- Ofertuesi EGLAND ka paraqitur kontrata, por nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit.

3- Në DST, Shtojca 10, "Specifikimet teknike", Referuar specifikimeve teknike, ofertuesi duhet të disponojë certifikatat: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, në të cilat duhet të jetë i përfshirë objekti i prokurimit.

- Në certifikatat e paraqitura nga ofertuesi perkatesisht: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 tek fusha e certifikimit nuk është përfshirë objekti i prokurimit.

4- Në DST, Shtojca 9, pika 2.3 "Kapaciteti teknik", germa "j",

*Çertifikat: Sistemi manaxhimit te Operacionit te saldimit EN (ISO 3834-4) : 2005.....*

Ofertuesit EGLAND i mungon kjo certifikatë.

5- Në DST, Shtojca 9, pika 2.3 "Kapaciteti teknik", germa "k",

*Çertifikat: Per veshje cilesore e ngjitjes dhe trashesia e veshjes Zn (zink) sipas EN (ISO 14 61) :2009 (Çertifikate e prodhuesit per te garantuar cilesine e produktit) Te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe).*

*Ofertuesi ne rast se nuk eshte prodhues per artikujt e lartepemendur, te paraqese Autorizim nga Prodhuesi, ose distributor i autorizuar, i cili merr persiper te furnizoje Ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. (Autorizimi te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe).*

Ofertuesi EGLAND ka paraqitur dy kontrata furzinimi në dy subjekte të ndryshme në të cilat nuk ka paraqitur certifikatat e kerkuara te prodhuesit.

KVO vendos qe ofertuesi EGLAND te mos kualifikohet.

Per ofertuesin c me vlerë të ofertës 11'827'200 lekë, KVO konstaton keto probleme:

1- Në DST, Shtojca 9, pika 1. "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit" pika a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.*

- Ofertuesi KLOSI-R COMPANY në fushen e veprimtarisë të QKR-se, nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

2- Në DST, Shtojca 9, pika 2.3 "Kapaciteti teknik", germa "f",

*Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 4'900'000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) vitevetë fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme.....*

- Ofertuesi KLOSI-R COMPANY ka paraqitur kontrata, që nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit, vetem një fature per kazana qe ka paraqitur ofertuesi, nuk ka vlerën e kerkuar.

3- Në DST, Shtojca10, “Specifikimet teknike”,  
Referuar specifikimeve teknike, ofertuesi duhet të disponoje certifikatat: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ne tecilat duhet te jete i perfshire objekti i prokurimit.

- Në certifikatat e paraqituara nga ofertuesi perkatesisht: ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 tek fusha e certifikimit nuk është përfshirë objekti i prokurimit.

KVO vendos qe ofertuesi KLOSI-R COMPANY të mos kualifikohet.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik ZEQIRI shpk, Adresa: Fier, Lagja Bishanak, rruga Skenderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banese private, Pasuria nr.1/1088, Kati I-rë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 10’684’800 (dhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Durrës, Sheshi “Liria” Durrës, tel/fax 052222310, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.11.2020.

Ankesa: Po

kanë marrë përgjigje me Vendim të KSHA nr. 11149/7 datë 17.11.2020, me Vendim e të KSHA nr. 11149/12 datë 27.11.2020

Njoftimi i Riklasifikimit (rivlerësimit) është bërë në datë 18.11.2020

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
ZËVENDËSKRYETAR**

**Emiriana Sako**